REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Nr. 1760/1 Prot. **Tiranë, më 11.07.2025**

VENDIM

Nr. 121, Datë 23.06.2025

"PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 98, DATË 23.05.2025 "PËR RENDITJEN E KANDIDATËVE NË GARË PËR POZICIONIN E SHPALLUR VAKANT NR. 2 NË PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DURRËS, TË SHPALLUR ME VENDIMIN NR. 13, DATË 16.02.2024, TË KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË", DHE TRANSFERIMIN E PROKURORIT MATILDA FETAU NË PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DURRËS, NËPËRMJET PROCEDURËS SË LËVIZJES PARALELE"

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, i përbërë nga:

1. Mirela BOGDANI	**Kryetar**
2. Erind GERMENJI	**Zv.Kryetar**
3. Sokol STOJANI	**Anëtar**
4. Zeqir HODA	**Anëtar**
5. Arta MANDRO	**Anëtar**
6. Ledina RIZA	**Anëtar**
7. Moisi DUDA	**Anëtar**
8. Vatë STAKA	**Anëtar**
9. Olger EMINAJ	**Anëtar**
10. Erind MERKURI	**Anëtar**
11. Erion FEJZULLA	**Anëtar**

në mbledhjen e datës 23.06.2025, në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenet 159-161, 164 dhe vijues të Ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, nenet 18 e vijues, të Rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Këshillit të Lartë të Prokurorisë", shqyrtoi çështjen me objekt:

"Për një ndryshim në Vendimin nr. 98, datë 23.05.2025 "Për renditjen e kandidatëve në garë për pozicionin e shpallur vakant nr. 2 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, të shpallur me Vendimin nr.13, datë 16.02.2024, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe transferimin e prokurorit Matilda Fetau në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele"

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË:

Pasi mori në shqyrtim Relacionin shoqërues Nr. 1760 prot., datë 18.06.2025, të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, me Relator z. Sokol Stojani, si dhe referuar bazës ligjore të sipërpërmendur, përfshirë diskutimet në mbledhje mbi çështjen,

V Ë R E N:

1. Këshilli i Lartë i Prokurorisë *(në vijim Këshilli)* është institucioni që garanton pavarësinë, disiplinën, statusin dhe karrierën e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.

2. Me Vendimin nr. 13, datë 16.02.2024, *"Për shpalljen e 18 (tetëmbëdhjetë) vendeve vakante për procedurën e transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm"*, Këshilli shpalli 18 (tetëmbëdhjetë) vende vakante në Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, Elbasan, Lezhë, Sarandë, Tiranë, Korçë, Kukës dhe Vlorë, të cilat do të plotësohen nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele.

   Njëri, ndër vendet e shpallura, është pozicioni vakant Nr. 2, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

3. Të dhënat lidhur me subjektet që kanë të drejtë të kandidojnë, kushtet ligjore, afati deri kur pranohen aplikimet etj,, janë njoftuar në faqen zyrtare të internetit, të Këshillit, në datë 20.02.2024.

4. Pas përfundimit të afatit të aplikimit, në datë 06.03.2024, Komisioni i Zhvillimit të *Karrierës (në vijim Komisioni)* filloi punën me verifikimin e plotësimit të kushteve ligjore, nga ana e kandidatëve që kanë aplikuar për këtë pozicion, që është edhe *faza e parë* e procedurës së transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele. Në përfundim të këtij procesi, Komisioni i propozoi Këshillit miratimin e listës së kandidatëve, të cilët plotësojnë kushtet ligjore të kandidimit.

5. Bazuar në nenin 43, pika 6, të Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar *(në vijim Ligji për Statusin)* dhe nenin 15, të Rregullores "Për transferimin e prokurorëve nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele" *(në vijim Rregullorja)*, me Vendimin nr. 37, datë 28.03.2024, *"Për fillimin e verifikimit të*

kandidatëve për plotësimin e kushteve ligjore të kandidimit për procedurën e transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele, të shpallur me Vendimin nr. 13, datë 16.02.2024, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë", Këshilli miratoi listën e kandidatëve që u kualifikuan për të vijuar garën.

6. Në po të njëjtin vendim, Këshilli vendosi caktimin, me short, të relatorit për secilin nga pozicionet e shpallura, ku për pozicionin vakant Nr. 2, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës u zgjodh si Relator, Anëtari i Komisionit, Z. Sokol Stojani.

7. Në zbatim të nenit 11, pikat 1 dhe 2, të Rregullores, kandidatët e kualifikuar për këtë pozicion janë njoftuar, nga ana e Relatorit, për fillimin e procedurës së vlerësimit të kandidatëve, si dhe për të drejtën për të kërkuar përjashtimin e Relatorit apo ndonjë Anëtari të Këshillit, në rast të ekzistencës së një shkaku të konfliktit të interesit. Në vijim, rezultoi se nuk është paraqitur asnjë kërkesë për përjashtimin e Relatorit apo ndonjë Anëtari të Këshillit.

8. Meqenëse nuk ka pasur asnjë kërkesë për përjashtimin e Relatorit, puna ka vijuar me renditjen e kandidatëve dhe verifikimin e kritereve përkatëse, bazuar në nenin 43, pika 7, të Ligjit për Statusin, si dhe në nenet 16, 17, 19 dhe 41 të Rregullores, që është edhe *faza e dytë* e procedurës së transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele.

9. Me Vendimin nr. 98, datë 23.05.2025, *"Për renditjen e kandidatëve në garë për pozicionin Nr. 2, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, të shpallur me Vendimin nr. 13, datë 16.02.2024, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë"*, Këshilli ka miratuar renditjen e kandidatëve në garë për pozicionin vakant Nr.2 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, si më poshtë:

   i. Arian Xhaferraj;
   ii. Marsida Frashëri.

10. Në këtë vendim është miratuar edhe mosvazhdimi i procedurës së transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele, për kandidaten *Matilda Fetau.*

11. Me Vendimin tjetër me nr. 97, datë 23.05.2025, "Për renditjen e kandidatëve në garë për pozicionin Nr. 1, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, të shpallur me Vendimin nr. 13, datë 16.02.2024, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë", prokurori Arian Xhaferraj është kualifikuar si kandidat për pozicionin vakant Nr. 1 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, të cilën e ka preferencë të parë (ku është kandidat i vetëm).

12. Për sa i përket kandidates, znj. Marsida Frashëri, rezulton se ajo ka qenë ende në procesin e rivlerësimit kalimtar dhe Kolegji i Posaçëm i Apelimit me Vendimin nr. 46 (JR), datë 10.06.2025, ka vendosur shkarkimin e saj nga detyra.

13. Ndodhur në këto kushte, rezulton se të dy kandidatët e kualifikuar për këtë pozicion, për arsyet e sipërpërmendura, nuk mundet që të emërohen më.

14. Pavarësisht këtij fakti, megjithëse Këshilli, me Vendimin nr. 98, datë 23.05.2025, ka vendosur ndalimin e kandidimit për kandidatët e tjerë, rezulton se procedura administrative për këtë pozicion nuk ka përfunduar. Kështu, në nenin 43, pika 7, të Ligjit për Statusin, parashikohet se:

> *"7. Këshillat shqyrtojnë kandidimet dhe rendisin magjistratët që përmbushin kërkesat, sipas rezultateve të mëposhtme:*
> *a) së pari, dy vlerësimet e mëparshme, duke përfshirë edhe ato si magjistrat i komanduar, duke pasur parasysh:*
> *i) që përvoja në pozicionet e komanduara si magjistrat në skemën e delegimit, që i ka mbaruar afati i caktimit ose delegimit, si anëtar i Këshillit që i ka mbaruar mandati 3 (tre) vjet përpara kandidimit, si gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese, si anëtar i Kolegjit Zgjedhor që i ka mbaruar mandati ose çdo pozicion tjetër që ligji e përcakton si vlerë të shtuar, do të ketë përparësi;*
> *ii) në rastet e më shumë magjistratëve me të njëjtën nivel vlerësimi, magjistratët brenda grupit të magjistratëve me rezultatet më të larta të vlerësimit, do të renditen sipas skemës së pikëve, të përcaktuar nga këshillat.*
> *b) së dyti, në rast se pas vlerësimit të bërë sipas shkronjës "a", të pikës 7, të këtij neni, ka më shumë se 1 (një) magjistrat me pikë më të larta, Këshilli i rendit këta magjistratë sipas përvojës profesionale, specifike, që kërkohet për pozicionin e lirë;*
> *c) së treti, në rast se pas vlerësimit të bërë sipas shkronjës "b", të pikës 7, të këtij neni, ka më shumë se 1 (një) magjistrat me pikë më të larta, Këshilli i rendit këta magjistratë sipas vjetërsisë si magjistra.".*

15. Ky parashikim është detajuar më tej në Rregullore, Kreu IV, nenet 23 – 44. Por, përcaktimi i renditjes nuk e përfundon procedurën administrative të transferimit, nëpërmjet lëvizjes paralele.

16. Ligji nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, në nenin 189, pika 3 të tij parashikon, se: *"Këshilli i Lartë i Prokurorisë zbaton Kodin e Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë në çdo rast, apo situatë tjetër, që nuk parashikohet shprehimisht nga ky ligj."*. Referuar parashikimeve të këtij Kodi, në nenin 90 të tij, parashikohet se:

"1. Procedura administrative, e nisur me kërkesë, ***përfundon me një vendimmarrje përfundimtare për çështjen, përkatësisht një akt administrativ*** *apo një kontratë administrative. Në vendimin përfundimtar për çështjen, organi publik vendos për të gjitha çështjet e ngritura nga palët gjatë procedurës dhe që nuk kanë marrë zgjidhje gjatë tij.*
2. Përfundimi i procedurës administrative, të nisur kryesisht, është në diskrecion të organit publik, përveçse kur parashikohet ndryshe nga ligji.
3. Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ."

17. Nga sa më sipër, nga analiza e nenit 43, të Ligjit për Statusin, si edhe e neneve 23 – 44 të Rregullores, rezulton që vendimmarrja e Këshillit për renditjen e kandidatëve nuk është një "vendimmarrje përfundimtare". Përkundrazi, vendimmarrja përfundimtare e kësaj procedure, parashikohet nga Kreu V, neni 45, i Rregullores, dispozitë e cila parashikon se:

"1. Jo më vonë se 7 ditë nga marrja formë të prerë sipas ligjit të vendimit për renditjen e kandidatëve në një procedurë lëvizje paralele, mbi projektvendimin e përgatitur nga relatori, ***Këshilli merr vendim për transferimin në atë pozicion të lirë të kandidatit të renditur më lart.***
2. Vendim i Këshillit i njoftohet prokurorit të transferuar, prokurorive respektive, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit. Një kopje e vendimit bëhet pjesë e dosjes personale të prokurorit të transferuar".

18. Siç rezulton nga parashikimi i mësipërm, vendimmarrja përfundimtare, realizohet në një fazë tjetër, mbas përfundimit të afateve ankimore kundër vendimmarrjes së Këshillit për renditjen e kandidatëve. Ky qëndrim, përforcohet edhe nga parashikimi i nenit 45/1, e cila ndër të tjera parashikon, se:

"Këshilli vendos përfundimin e një procedure pa vendim përfundimtar në rastet e mëposhtme:
...
b) kur në vijim të procedurës së transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele, nuk mbetet asnjë kandidat në atë procedurë".

19. Në rastin konkret, rezulton që kanë mbetur kandidatë në këtë procedurë dhe, për rrjedhojë, parashikimi i mësipërm, e ndalon Këshillin që të vendosë përfundimin e kësaj procedure pa një vendim përfundimtar.

20. Për më tepër, duke qenë se jemi përpara një procedure të hapur kryesisht nga vetë Këshilli, në kuptim të pikës 2, të nenit 90, të Kodit të Procedurave Administrative mbetet në diskrecionin e vetë Këshillit, mënyra e përfundimit të kësaj procedure,

21. Për sa më sipër, duke qenë se ka vend për ndryshimin e vendimmarrjes së Këshillit, për renditjen e kandidatëve, lind nevoja e ndryshimit të Vendimit nr. 98, datë 23.05.2025, të Këshillit, të cituar më sipër, nëpërmjet të cilit është miratuar renditja e kandidatëve për pozicionin vakant Nr. 2 në zyrën e Prokurorisë Durrës.

22. Këshilli vlerëson, se në këtë rast gjen zbatim edhe neni 18, pika 2, e Kodit të Procedurave Administrative, titulluar "*Parimi i deburokratizimit dhe i efiçensës*", ku parashikohet, se: *"Procedura administrative zhvillohet sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se afati kohor i parashikuar me ligj për të, me sa më pak kosto për organin publik dhe për palët, në mënyrë që të arrihet çfarë është e nevojshme për një rezultat të ligjshëm".*

23. Referuar kësaj dispozite, rezulton se zbatimi i këtij parimi kërkon që të plotësohen kumulativisht këto kushte:

    a) procedura të zhvillohet sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se afati kohor i parashikuar me ligj për të;
    b) me sa më pak kosto për organin publik dhe për palët;
    c) në mënyrë që të arrihet çfarë është e nevojshme për një rezultat të ligjshëm.

24. Bazuar në tërësinë e rrethanave faktike të përshkruara më sipër, rezulton se këto tre kushte plotësohen, pasi:

    <u>*Së pari*</u>, synohet qëllimi kryesor që procedura të zhvillohet sa më shpejt të jetë e mundur; <u>*Së dyti*</u>, rezulton që plotësohet në këtë rast edhe kriteri i dytë, pasi procedura ul kostot, si për organin publik, Këshillin në këtë rast, ashtu edhe për prokuroren që kërkohet të vijojë procedurën e transferimit. Përderisa për këtë pozicion nuk mbeten kandidatë të tjerë në garë, renditja dhe transferimi i prokurores Matilda Fetau mund të realizohet menjëherë, pa e zgjatur më tej procedurën me hapa të tjerë formalë.

25. *Së treti*, rezulton që edhe kriteri i tretë plotësohet në këtë rast, pasi emërimi i prokurores Matilda Fetau në këtë pozicion nuk shmang asnjë hap apo procedurë që duhej ndjekur sipas legjislacionit në fuqi, si edhe nuk shkel të drejtat e palëve të interesuara. Duhet theksuar, se sipas përkufizimit që jep Kodi i Procedurave Administrative, në nenin 3, pika 7, germa "a" të tij, rezulton se: *""Palë" është: a) çdo person fizik ose juridik, i cili ka të drejtë ose interes legjitim të drejtpërdrejtë në një procedurë administrative, siç përcaktohet në nenin 33, pika 1 të këtij Kodi;"* Më tej neni 33, pika 1, e këtij Kodi parashikon, se: *"1. Palë në procedurën administrative, përveç sa parashikohet në nenin 3, të këtij Kodi, është çdo person: a) me kërkesë të të cilit ka filluar procedura administrative".*

26. Meqenëse kandidatja Matilda Fetau mbetet kandidate e vetme, e kualifikuar për pozicionin vakant Nr. 2, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, kandidatja në fjalë renditet e para, duke mos kaluar në vlerësimin krahasues të treguesve, të kritereve dhe përparësive të tjera sipas të Ligjit për Statusin dhe Rregullores.

27. Në bazë të nenit 64, pika 4 të këtij Kodi, Këshilli duhet të vijojë me caktimin në detyrë të prokurores në këtë pozicion të shpallur, me qëllim realizimin e interesave të ligjshme të prokurores Matilda Fetau.

28. Prokurorja Matilda Fetau është emëruar si prokurore me Vendimin nr. 177, datë 12.07.2022, ndërsa me Vendimin nr. 201, datë 27.07.2022, është caktuar në detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kurbin. Me Vendimin nr. 82, datë 24.04.2023, "*Për transferimin e përhershëm pa pëlqim të prokurorëve nga prokuroritë pranë gjykatave të shkallëve të para të cilat shkrihen për efekt ristrukturimi*" është transferuar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë.

29. Sa i takon hyrjes në fuqi të aktit dhe krijimit të pasojave, në kuadër të mirëfunksionimit të sistemit të prokurorisë dhe kalimi të detyrës në mënyrë graduale, vlerësohet aplikimi i pikës 3, të nenit 104, "*Fillimi dhe përfundimi i pasojave juridike të aktit administrativ*", të Kodi i Procedurave Administrative, ku përcaktohet se:

> "*1. Një akt administrativ fillon të sjellë pasoja juridike ndaj palës së cilës i drejtohet apo interesat e së cilës preken nga akti, me njoftimin e përmbajtjes së aktit palëve.*
> *2. Akti administrativ i miratuar në heshtje fillon të sjellë pasoja juridike, në ditën e përfundimit të afatit për njoftimin e tij, sipas nenit 97 të këtij Kodi.*
> *3. Një akt administrativ mund të fillojë të sjellë pasoja juridike në një datë tjetër, të caktuar shprehimisht nga vetë akti, por në asnjë rast përpara njoftimit të palës, sipas pikës 1 të këtij neni. Në këtë rast, data e fillimit të pasojave juridike caktohet shprehimisht në pjesën e dispozitivit të aktit administrativ të shkruar.*
> *4. Një akt administrativ sjell pasoja juridike:*
> *a) për sa kohë nuk është anuluar apo shfuqizuar, kryesisht apo si rezultat i ushtrimit të mjeteve ligjore administrative ose gjyqësore;*
> *b) për sa kohë nuk ka përfunduar afati i aktit ose nuk është përmbushur qëllimi i tij; ose*
> *c) për çfarëdo arsyeje tjetër të parashikuar nga ligji*".

30. Referuar sa më sipër, pasojat juridike të aktit administrativ dhe fillimi i ushtrimit të detyrës efektive në zyrën e prokurorisë pritëse, në kuadër të mirëfunksionimit të sistemit të prokurorisë do të krijohet në një moment të dytë, konkretisht në datë 07.07.2025.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës, në nenin 43, të Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa "a" të Ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, në nenet 18 dhe 90 pika 2, 104 pika 3 dhe 113 pika 2, të Ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe nenet 9, pika 1, germa "b", 10, 23-26, 43 dhe 44, të Rregullores "Për transferimin e prokurorëve nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele", e ndryshuar, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Ndryshimin e pikës 1, të Vendimit nr. 98, datë 23.05.2025, të Këshillit dhe renditjen e kandidates Matilda Fetau si kandidatja e parë dhe e vetme për pozicionin vakant Nr. 2, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, të shpallur me Vendimin nr. 13, datë 16.02.2024, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

2. Shfuqizimin e pikës 2, të Vendimit nr. 98, datë 23.05.2025, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

3. Transferimin e prokurorit Matilda Fetau në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele.

4. Marrëdhëniet financiare që lidhen me pagën dhe përfitimet e tjera do të përballohen nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, duke filluar nga data 07.07.2025.

5. Të njoftohen për këtë vendim Prokurori i Përgjithshëm, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë dhe prokurori Matilda Fetau.

6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

U shpall në Tiranë, sot më 23.06.2025.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETAR
Mirela Bogdani

ZV/KRYETAR
Erind Germenji

ANËTAR
Sokol Stojani

ANËTAR
Zeqir Hoda

ANËTAR
Arta Mandro

ANËTAR
Ledina Riza

ANËTAR
Moisi Duda

ANËTAR
Vatë Staka

ANËTAR
Olger Eminaj

ANËTAR
Erind Merkuri

ANËTAR
Erion Fejzulla